



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN KRYESISHT TË ANËTARIT TË KZAZ NR. 77, PËR ZGJEDHJET PËR
ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 19.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për lirimin dhe emërimin kryesisht të anëtarit të KZAZ nr. 77, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 32, pika 2, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin,

V Ë R E N

Me shkresën nr.3871 prot., datë 18.05.2019, z.Endri Çomani, anëtar i KZAZ nr.77 i emëruar kryesisht me vendimin Nr. 141, datë 09.04.2019 të KQZ, për arsye objektive ka paraqitur dorëheqjen.

KQZ bazuar në nenin 32, pika 2, të Kodit Zgjedhor, liron nga detyra anëtarin e KZAZ nr. 77, z. Endri Çomani. Plotësimi i vakancës do të bëhet duke përzgjedhur nga lista e shtetasve të miratuar nga KQZ me vendimin nr. 140, datë 09.04.2019, sipas procedurës së përcaktuar në Udhëzimin nr. 04 datë 19.02.2013, të ndryshuar me Vendimin nr.127, datë 04.04.2019.



Nr. 574 i Vendimit Data 19.05.2019 e Vendimit Ora 18:00 e Vendimit

Për lirimin dhe emërimin kryesisht të anëtarit të KZAZ nr. 77, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 29, pika 5, nenin 32, pika 1 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

1. Të lirojë nga detyra anëtarin e emëruar kryesisht të KZAZ-së nr.77, z. Endri Astrit Çomani, Bashkia Tepelenë.
2. Të emërojë kryesisht z. Maksim Alush Shehu, anëtar të KZAZ-së nr.77, Bashkia Tepelenë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 574 i Vendimit Data 19.05.2019 e Vendimit Ora 18:00 e Vendimit

Për lirimin dhe emërimin kryesisht të anëtarit të KZAZ nr. 77, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.